



KOMUNA E RAHOVECIT

OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

ANEKS KONTRATA

INVESTIMET NË TURIZËM - SHTIGJET E ECJES NË KOMUNËN E RAHOVECIT

Nr. Ref. 623-20-4220-5-3-5

Nr. i brendshëm. 623-19-066-5-2-1/5

Autoriteti Kontraktues: **KOMUNA E RAHOVECIT**, dhe

N.N.T. "ETNIKU" me adresë në **Suharekë**, të cilën e përfaqëson **Tahir Bugari**, në tekstin e mëtejme ("Kontraktuesi"), janë pajtuar të lidhin këtë Aneks kontratë:

- I. Duke pasur parasysh se palët kontraktuese të përmendura më lartë kanë lidhur kontratë mbi kryerjen e punëve për: **[Investimet në turizëm – Shtigjet e ecjes në Komunën e Rahovecit]**, me nr. të prokurimit **[623-19-7196-5-2-1 & 623-19-066-5-2-1]**, të datës: **[31.10.2019]**, e cila kontratë është në realizim e sipër.
- II. Duke u bazuar në kërkesën për punë shtesë nga menaxheri i projektit dhe arsyetimet për mospërfshirjen e punëve shtesë në kontratën bazë, në njoftimin për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik për procedurë të negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, në vendimin mbi aprovimin e punëve shtesë të kontratës dhe kryerjen e suksesshme të punëve për **[Investimet në turizëm – Shtigjet e ecjes në Komunën e Rahovecit]**, Autoriteti Kontraktues dhe Kontraktuesi pajtohen që të lidhin aneks kontratë për kryerjen e punëve shtesë sipas ofertës së datës **[13.08.2020]** me kushte të njëjta si në kontratën bazë.
- III. Kontrata hynë në fuqi me datën e nënshkrimit, ndërsa ekzekutimi i punëve dhe/ose shërbimeve duhen të përfundohen në afat jo më të gjatë se: **15 ditë pune** pas fillimit të ekzekutimit të Punëve dhe/ose Shërbimeve.

ME KËTË U PAJTUAN SI VIJON:

1. Kontrata bazë që është duke u përmbushur, është vazhduar edhe për kryerjen e punëve shtesë të pa parashikuara si marrëveshje reciproke në mes palëve.
2. Çmimi i punëve shtesë është gjithsej: **4,905.00 €**
(Katër mijë e nëntëqindpesë euro e zero zero Cent)
sipas përshkrimeve të punëve dhe sasive të dhëna në Dosjen e tenderit nr. **[623-20-4220-5-3-5 & 623-19-066-5-2-1/5]**.
3. Punët shtesë kontraktohen bazuar në përshkrimin e punëve shtesë të Menaxherëve të Projektit, Njoftimit në KRPP dhe kushteve të negociuara në mes të Autoritetit Kontraktues dhe Kontraktuesit që janë pjesë e këtij Aneksi të Kontratës.
4. Pagesa e punëve shtesë do të bëhet në bazë të konstatimit të Personave të Autorizuar të Autoritetit Kontraktues pas perfundimit të punëve.
5. Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:
 - a. Marrëveshja e kontratës;
 - b. Përshkrimi i punëve shtesë nga Menaxherët e projektit që duhet të realizohen;
 - c. Njoftimi në KRPP për punët shtesë.
6. Të gjitha kushtet tjera të kontratës bazë mbesin të njëjta.

Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një original për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:		Për Kontraktuesin:	
Emri:	Astrit Mullabazi	Emri:	Tahir Bugari
Pozita:	Menaxher i Prokurimit	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	26.08.2020	Data:	26.08.2020
Vula:		Vula:	

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA E PUNËVE SHITESË
PUNËVE NDËRTIMORE PËR NDËRTIMIN E SHTIGJEVE TË ECJES NË
KOMUNËN E RAHOVECIT**

III	SHTEGU I ECJES NË KRUSHË TË MADHE				
B	Punët e dheut dhe të Zhavorit				
2	Furnizimi, transporti, shtruarja dhe ngjeshja e zhavorit me fraksion fr0-63mm me trashësi t=15cm, përgjatë tërë gjatësisë dhe gjerësisë së shtegut për këmbësor.	m ³	640	4.5	2,880.00
4	Furnizimi, transporti, shtruarja, rrafshimi dhe planifikimi i zhavorit me Fr(0-32) mm me trashësi t=10cm.	m ³	450	4.5	2,025.00
B	Gjithsej Punët e dheut dhe të Zhavorit:				4,905.00
III	GJITHSEJ SHTEGU I ECJES NË KRUSHË MADHE:				4,905.00

REKAPITULIM		
C	SHTEGU I ECJES NË KRUSHË TË MADHE	4,905.00
	Gjithsej Punët:	4,905.00

Punekryesi:

